
'KULETAT' E SUBJEKTEVE POLITIKE PARLAMENTARE: SI QËNDROJNË FINANCIARISHT ATO?

DHJETOR, 2020



'KULETAT' E SUBJEKTEVE POLITIKE PARLAMENTARE: SI QËNDROJNË FINANCIARISHT ATO?

NËNTOR, 2020

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autor: **Eugen Cakolli**

Sqarim: Publikimi i këtij raporti¹ është bërë i mundur me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të Programit për Promovimin e Tranzicionit të implementuar në bashkëpunim me Transparency International Czech Republic (www.transparency.cz). Opinione, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi ekskluzive e KDI-së dhe e TICZ-së, ndaj nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

¹ Ky raport analizon raportet vjetore financiare të subjekteve politike parlamentare, të cilat janë ende të paaudituar nga organet përkatëse. Të njëjtat mund të pësojnë ndryshime.

■ ■ PËRMBAJTJA

LISTA E AKRONIMEVE.....	6
(MOS)PUBLIKIMI NË KOHË I RAPORTEVE FINANCIARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE	7
'LUFTA' E BRENDSHME NË KQZ: SEKRETARIATI vs. ZRPPC	8
PUBLIKIMI I RAPORTEVE VJETORE FINANCIARE TË PAAUDITUARA	10
PASURITË DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE POLITIKE PARLAMENTARE NË KOSOVË.....	10
TË HYRAT vs. SHPENZIMET	12
SI I SHPENZUAN PARATË SUBJEKTET POLITIKE?	14
DONACIONET E SUBJEKTEVE POLITIKE	18
PASQYRAT BANKARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE.....	21
REKOMANDIMET	22



LISTA E AKRONIMEVE

- AAK** Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
- AKR** Aleanca Kosova e Re
- BE** Bashkimi Evropian
- DnV** Demokracia në Veprim
- IRDK** Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
- JGP** Jedinstvena Goranska Partija
- KDI** Instituti Demokratik i Kosovës
- KDTP** Kosova Demokratik Turk Partisi
- KQZ** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- LDK** Lidhja Demokratike e Kosovës
- LS** Lista Serbe
- LVV** Lëvizja Vetëvendosje
- NDS** Nova Demokratska Stranka
- NISMA** Nisma Socialdemokrate
- PAI** Partia e Ashkalinjëve për Integrim
- PD** Partia e Drejtësisë
- PDAK** Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës
- PDK** Partia Demokratike e Kosovës
- PLE** Partia Liberale Egjiptiane
- PREBK** Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
- PSD** Partia Socialdemokrate
- PZAP** Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
- SLS** Samostalna Liberalna Stranka
- ZRPPC** Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim





(MOS)PUBLIKIMI NË KOHË I RAPORTEVE FINANCIARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Rregullativa ligjore në Kosovë lidhur me financimin e subjekteve politike vazhdimisht është vlerësuar si e avancuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të financimit². Megjithatë, sfidë serioze mbetet moszbatimi i duhur, e shpesh edhe keqinterpretimi i dispozitave ligjore që rregullojnë këtë sferë. Edhe pse partitë politike, në veçanti ato parlamentare financohen çdo vit me mbi 4 milion euro nga buxheti vjetor i shtetit, ato nuk janë treguar sa duhet transparente në lidhje me shpenzimin e tyre. Në këtë drejtim, publikimi i raporteve vjetore financiare është mbi të gjitha obligim ligjor i subjekteve politike, por edhe një nga format themelore të ofrimit të transparencës financiare, qoftë ajo minimale. Kjo duhet të pasohet me auditim të këtyre raporteve, që si proces, rëndom në Kosovë ka çaluar ndjeshëm, si rezultat i mungesës së vullnetit politik dhe pengesave tjera administrative në Kuvendin e Kosovës – në përzgjedhjen e auditorëve për kryerjen e auditimit të financave të subjekteve politike.

Që nga ndryshimi i ligjit për financimin e subjekteve politike në vitin 2013, asnjëherë nuk ka pasur publikim në kohë të raporteve vjetore financiare të subjekteve politike. Madje, në periudhën 2013-2017, Kuvendi kishte dështuar në të paktën pesë raste që të përzgjedhë auditorët, që kishte lënë publikun në ‘terr’ lidhur me mënyrën e financimit dhe shpenzimeve të subjekteve politike për plot katër vite. Kurse, raportet vjetore financiare të subjekteve politike për vitin 2018, nuk janë publikuar ende.

Përmes këtij ligji dhe dy plotësim-ndryshimeve të tij (2012 dhe 2013), përcaktohet që partitë politike duhet të dorëzojnë në KQZ raportin vjetor financiar deri më 1 mars të vitit vijues³. Po ashtu, ligji përcakton që deri më 30 korrik të vitit pasues, subjektet politike duhet ta publikojnë raportin vjetor financiar në mjetet e informimit, dhe i njëjti duhet të mbahet i publikuar për të paktën një vit. Sa i përket kontrollit financiar, me

plotësim-ndryshimin e ligjit për financimin e subjekteve politike të vitit 2013, është përcaktuar që procesi i auditimit të raporteve financiare të mbarojë deri më 15 qershor të vitit pasues. Në anën tjetër, KQZ duhet që raportet vjetore financiare dhe raportin përfundimtar të auditimit të publikojë në faqen e saj zyrtare më së largu deri më 30 qershor. Megjithatë, këto dispozita nuk janë respektuar asnjëherë deri më tani. Duke u thirrur në mungesën e raporteve të auditimit, KQZ, përkatësisht ZRPPC, kishte refuzuar publikimin e raporteve vjetore financiare. Madje, as kur Avokati i Popullit në vitin 2018, pas ankesës së KDI-së kundër KQZ-së lidhur me kufizimin e qasjes në dokumente publike, përkatësisht raportet financiare të pa audituara, kishte rekomanduar ofrimin e qasjes në këto

Që nga ndryshimi i ligjit për financimin e subjekteve politike në vitin 2013, asnjëherë nuk ka pasur publikim në kohë të raporteve vjetore financiare të subjekteve politike. Madje, në periudhën 2013-2017, Kuvendi kishte dështuar në të paktën pesë raste që të përzgjedhë auditorët, që kishte lënë publikun në ‘terr’ lidhur me mënyrën e financimit dhe shpenzimeve të subjekteve politike për plot katër vite.

² Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). *Analysis Of Political And Campaign Finance, Legal Framework And Political Party Compliance*. Qershor, 2020. Fq. 6.

³ Për më shumë, shih Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (2010). I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>





Kjo çështje është theksuar edhe në pothuajse të gjitha raportet e BE-së për Kosovën, të cilat në vazhdimësi kishin konstatuar se ekziston mungesë e theksuar e transparencës në raport me financimin e subjekteve politike dhe kampanjave të tyre. Përveç kësaj, edhe raportet vendore të organizatave të shoqërisë civile në mënyrë konsistente kanë kërkuar publikimin e këtyre raporteve.

raporte, KQZ sërish nuk kishte vepruar konform këtij rekomandimi. Avokati i Popullit i kishte vlerësuar se edhe në bazë të praktikave ndërkombëtare, respektivisht Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mohimi i qasjes së publikut në informacionet mbi funksionimin e organeve të shtetit, paraqet shkelje të së drejtës themelore të demokracisë.

Kjo çështje është theksuar edhe në pothuajse të gjitha raportet e BE-së për Kosovën, të cilat në vazhdimësi kishin konstatuar se ekziston mungesë e theksuar e transparencës në raport me financimin e subjekteve politike dhe kampanjave të tyre. Përveç kësaj, edhe raportet vendore të organizatave të shoqërisë civile në mënyrë konsistente kanë kërkuar publikimin e këtyre raporteve.

Situata kishte filluar të ndryshojë në tetor të këtij viti, kur Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike kishte dërguar për shqyrtim në Këshillin për Çështje Ligjore të KQZ-së, rekomandimin për publikimin e raporteve vjetore financiare të subjekteve politike për vitin 2019. Sipas këtij rekomandimi, 47 nga 48 partitë e regjistruara aktualisht, kanë dërguar raportet e tyre financiare brenda afateve të përcaktuara ligjore. Rekomandimi kishte ritheksuar faktin që procedura e zgjedhjes së auditorëve nga Kuvendi i Kosovës, përkatësisht Komisioni

për Mbikëqyrjen e Financave Publike nuk ka përfunduar ende. Andaj, ishte kërkuar publikimi i këtyre raporteve, në versionet e dorëzuara nga partitë politike, duke ua shtuar tekstin "*Këto raporte financiare janë të paaudituar dhe mund të pësojnë ndryshime dhe saktësime gjatë procesit të auditimit*".

Shqyrtimi i parë i këtij rekomandimi u bë më 7 tetor, gjatë mbledhjes së 40-të të KQZ-së. Si rezultat i mos pajtimeve lidhur me këtë çështje mes anëtarëve të KQZ-së, propozimi nuk ishte hedhur fare në votim. Gjatë takimit ishte e bërë e ditur që nga Këshilli për Çështje Ligjore, me shumicë votash⁴ kishte vendosur që të mos e dërgojë për shqyrtim në mbledhjen e KQZ-së, pa marrë paraprakisht një interpretim ligjor nga Departamenti Ligjor i KQZ-së.

'LUFTA' E BRENDSHME NË KQZ: SEKRETARIATI vs. ZRPPC

KQZ është kritikuar shpesh për mospublikim në kohë të raporteve financiare të subjekteve politike⁵. Kjo i është atribuar konkretisht Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, mbi të cilën bie përgjegjësia e garantimit të transparencës financiare të subjekteve politike. Që

⁴ Përfaqësuesit e subjekteve politike AAK, NISMA dhe VAKAT kishin votuar 'kundër', ndërsa përfaqësuesi i LVV kishte votuar 'për', lidhur me rekomandimin e publikimit të këtyre raporteve, në versionet e paaudituar.

⁵ Për më shumë, shih Raportin e BE-së për Kosovën (2016). I qasshëm në: https://www.mei-ks.net/repository/docs/20170717114956_raporti_i_progresit_2016_shqip.pdf



nga viti 2019, është vërejtur përmirësim i ndjeshëm si në funksionimin e brendshëm të Zyrës, ashtu edhe në rritjen e nivelit të transparencës që e njëjta ka ofruar për publikun, sidomos në raport me financat e subjekteve politike. Ndër tjerash, vlen të përmendet që më 10 dhjetor 2019, për herë të parë ishin publikuar në kohë Dosjet e Informimit Publik, e cila përfshin regjistrin e donatorëve të secilit subjekt politik, raportet e Publikimit Financiar të Fushatës të subjekteve politike të dorëzuara tek KQZ-ja dhe formularët e Publikimit Financiar për Kandidatë për kandidatët që kanë fituar ulëse në Kuvendin e Kosovës sipas rezultateve të certifikuara. Këto të dhëna ishin bërë të qasshme edhe për publikun, përmes faqes zyrtare të KQZ-së.⁶

Kjo ishte pasuar edhe me rekomandimin për publikimin e raporteve financiare të subjekteve politike për vitin 2019, të cilat janë të paaudituar. Megjithatë, deri tek publikimi i tyre më 21 tetor të këtij viti, pra rreth dy javë pas rekomandimit, KQZ ishte karakterizuar me përplasje të brendshme, veçanërisht lidhur me interpretimin e dispozitave përkatëse ligjore për mundësinë e publikimit të raporteve të paaudituar. Kjo për shkak se fillimisht, Departamenti Ligjor i KQZ-së kishte nxjerrë një interpretim ligjor, me anë të së cilit, rekomandimi i ZRPPC-së ishte konsideruar si jo i plotë, ndërsa ishte kërkuar mospublikimi i raporteve të paaudituar nga ana e KQZ-së. Sipas këtij interpretimi ligjor, ishte konstatuar që *"raporti i dorëzuar nga subjektet politike nuk është i plotë për publikim në bazë të nenit 19 paragrafi 10."*

Megjithatë, përkundër këtij interpretimi ligjor, si dhe duke marrë parasysh edhe kërkesën e vazhdueshme të KDI-së⁷ por edhe organizatave tjera jo-qeveritare për publikim të raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas shumë diskutimeve – në të cilat përfaqësuesit e subjekteve politike në KQZ kishin shprehur përkrahjen për publikimin e tyre, meqë sipas tyre nuk ka çfarë të fshihet – më 21 tetor KQZ kishte vendosur për publikimin e raporteve financiare.

Megjithatë, përkundër këtij interpretimi ligjor, si dhe duke marrë parasysh edhe kërkesën e vazhdueshme të KDI-së por edhe organizatave tjera jo-qeveritare për publikim të raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas shumë diskutimeve – në të cilat përfaqësuesit e subjekteve politike në KQZ kishin shprehur përkrahjen për publikimin e tyre, meqë sipas tyre nuk ka çfarë të fshihet – më 21 tetor KQZ kishte vendosur për publikimin e raporteve financiare.

⁶ Për më shumë, shih Dosjen e Informimit Publik, të publikuar nga KQZ-ja më 10 dhjetor 2019. E qasshme në: <https://www.kqz-ks.org/lajmet/kqz-publikon-dosjen-e-informimit-publik-per-subjektet-politike-dhe-kandidatet-e-zgjedhjeve-2019/>

⁷ Për më shumë, shih reagimin e KDI-së lidhur me publikimin e raporteve financiare të paaudituar të subjekteve politike për vitin 2019. I qasshëm në: <https://www.facebook.com/kosovademocraticinstitute/posts/10159772209584179>





PUBLIKIMI I RAPORTEVE VJETORE FINANCIARE TË PAAUDITUARA

Subjektet politike, përkatësisht ato parlamentare, përfitojnë nga paratë e taksapaguesve, përkatësisht buxheti i shtetit, rreth 4.2 milionë euro çdo vit. Këto mjete ndahen për subjektet politike përmes Fondit për mbështetjen e subjekteve politike për financimin e aktiviteteve të rregullta, përmes së cilit është paraparë që rreth 3,8 milion euro të ndahen për subjektet politike ndërsa mbi 400 mijë euro për grupet përkatëse parlamentare. Janë gjithsej 13 subjekte parlamentare, që kanë fituar ulëse në legjislaturën e dalë nga zgjedhjet e vitit 2017, të cilat kanë përfiturar çdo vit mjete nga ky fond. Këto mjete janë ndarë deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019⁸. Bazuar në numrin e mandateve, përfituesit kryesorë të këtij fondi ishin subjektet e ish-koalicionit PAN (PDK, AAK, NISMA dhe të tjerat) me gjithsej 1,228,500 euro/në vit, pasuar nga Lëvizja Vetëvendosje me 1,008,000 euro, koalicioni LDK-AKR me 913,500 euro, Lista Serbe me 283,500 euro, KDTP dhe koalicioni VAKAT me nga 63,000 euro, si dhe NDS, SLS, PDAK, PLE, JGP, PAI dhe PREBK me nga 31,500 euro secila.

Duke qenë se është kërkesë ligjore, si dhe faktit që këto mjete janë para publike, ka qenë kërkesë e vazhdueshme që të publikohen raportet vjetore financiare të subjekteve politike, në mënyrë që publiku të ketë informacione se si shpenzohen paratë e buxhetit shtetëror.

Lidhur me këtë, pas diskutimeve të shumta, KQZ, më 21 tetor, kishte marrë këtë vendim me vota unanime në favor të rekomandimit të për publikimin e raporteve vjetore financiare të paaudituar. Këto raporte ishin publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së më shumë se 10 ditë pas, përkatësisht më 2 nëntor.⁹ Sipas faqes zyrtare të KQZ-së, shihet

se janë gjithsej 46 raporte vjetore financiare të subjekteve politike, të cilat tashmë janë publikuar.

Megjithatë, vlen të përmendet që ndonëse është shënuar hap pozitiv me publikimin e këtyre raporteve, raportet financiare janë të mangëta, meqë nuk ofrojnë fare informacione lidhur me shpenzimet e kandidatëve, shpenzimet e degëve të subjekteve politike, apo forumeve të brendshme, qoftë të grave apo të rinisë.

Në pjesën në vijim do të analizohen vetëm raportet vjetore financiare të subjekteve politike për vitin 2019, të cilat aktualisht janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, marrë parasysh faktin që të dhënat e subjekteve tjera nuk zgjojnë interesim të madh publik, si dhe kanë shpenzime dhe të hyra krejtësisht minimale.

PASURITË DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE POLITIKE PARLAMENTARE NË KOSOVË

Subjektet politike parlamentare për vitin 2019 kanë deklaruar pasuri afatgjata dhe afatshkurta në vlerë të përgjithshme prej mbi 420 mijë eurosh. Në këtë kategori përfshihen tokat, objektet, pajisjet, pasuritë e paprekshme, llogaritë e arkëtueshme, parapagimet, paratë dhe pasuritë e tjera. Subjekti që ka deklaruar më së shumti pasuri është Lëvizja Vetëvendosje, në vlerë prej gjithsej 136,508 euro. LVV pasohet nga PDK me 70,986 euro, AAK me 45,724 euro, NISMA me 42,044 dhe Lista Serbe me 40,255 euro. Subjektet politike IRDK dhe PAI kanë deklaruar se nuk kanë fare pasuri. Ndërsa, subjekti më i madh politik i koalicionit ak-

⁸ Më 31 tetor 2019, KQZ kishte marrë vendim për plotësimin e vendimit lidhur me mjetet e ndara nga Fondi, sipas të cilit KQZ lejon transferimin e fondeve nga Fondi tek subjektet politike vetëm deri në datën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit. Po ashtu, sipas vendimit, autorizohet transferimi i fondeve nga Fondi në baza mujore deri në certifikimin e rezultateve, që kishte ndodhur më 27 nëntor.

Për më shumë, shih vendimin: <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/1631-2019-Vendim-per-aktimin-e-lartesisise-se-mjeteve-te-fondite-per-subjekte-politike.pdf>


⁹ Për më shumë, shih: <https://www.kqz-ks.org/lajmet/kqz-publikoi-raportet-financiare-te-partive-politike-per-vitit-2019/>





Subjektet politike parlamentare për vitin 2019 kanë deklaruar pasuri afatgjata dhe afatshkurta në vlerë të përgjithshme prej mbi **420 mijë eurosh**.

Në këtë kategori përfshihen tokat, objektet, pajisjet, pasuritë e paprekshme, llogaritë e arkëtueshme, parapagimet, paratë dhe pasuritë e tjera.



Subjektet politike **IRDK** dhe **PAI** kanë deklaruar se nuk kanë fare pasuri.

Ndërsa, subjekti më i madh politik i koalicionit aktual qeverisës, Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar vetëm 12,817 euro pasuri, duke u renditur kështu si vetëm subjekti i tetë me më së shumti pasuri.



tual qeverisës, Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar vetëm 12,817 euro pasuri, duke u renditur kështu si vetëm subjekti i tetë me më së shumti pasuri.

Në anën tjetër, sipas raporteve, duket se subjektet politike nuk qëndrojnë mirë me detyrimet që kanë. Kjo për shkak se subjektet politike kanë deklaruar rreth 2 milion euro

detyrime, ku përfshihen huatë e pagueshme, të hyrat e shlyera, llogaritë e pagueshme dhe detyrime tjera. Në fakt, vetëm dy subjektet – PDK dhe LDK – kanë deklaruar mbi 1,1 milion euro, apo gati 2/3 e detyrimeve të përgjithshme të të gjitha subjekteve politike parlamentare në Kosovë. PDK ka deklaruar 612 mijë euro detyrime, ndërsa LDK 503 mijë euro detyrime. Pas tyre radhitet AAK me plot 463 mijë euro





detyrime, pasuar nga NISMA me 78 mijë euro, LVV me 34 mijë euro, NDS me 7 mijë euro, KDTP me mbi 6 mijë euro, Alternativa me mbi 4 mijë euro, PREBK me 2 mijë euro si dhe PLE me 150 euro detyrime. LS, Koalicioni VAKAT, PAI, IRDK dhe JGP nuk kanë deklaruar asnjë detyrim.

TË HYRAT vs. SHPENZIMET

Subjektet politike parlamentare duket që janë në borxhe të shumta, në kuptim të bilancit negativ mes të hyrave dhe shpenzimeve që ato kanë deklaruar përgjatë vitit 2019. Ato kanë deklaruar 4 milion e 665 mijë euro të hyra, ndërsa kanë shpenzuar 5 milion e 433 mijë euro. E si burim kryesor të të hyrave të tyre, subjektet politike i kanë deklaruar mjetet që marrin nga buxheti i shtetit, përmes Fondit për mbështetjen e subjekteve politike.

Në përgjithësi, subjekti me më së shumti të hyra të deklaruar për vitin 2019 është PDK me mbi 1,2 milion euro. Pas PDK-së radhiten LVV me mbi 1,1 milion euro, LDK me mbi 910 mijë euro, AAK me mbi 320 mijë euro, LS me 300 mijë euro, NISMA me 200 mijë euro, AKR me 120 mijë euro, KDTP me rreth 90 mijë euro dhe koalicioni VAKAT me rreth 65 mijë euro. Pas tyre renditen subjektet tjera Alternativa, PLE, PAI, NDS, PREBK, JGP të cilat kanë deklaruar rreth 30 mijë euro të hyra secila.

Megjithatë, renditja pëson disa ndryshime sa i përket shpenzimeve që subjektet politike parlamentare kanë pasur gjatë vitit të kaluar. Ndonëse PDK vazhdon të prijë sërish, me rreth 1 milion e 360 mijë euro shpenzime, pas saj radhitet LDK me rreth 1 milion e 340 mijë euro shpenzime. E treta është LVV me rreth 1 milion e 160 mijë euro shpenzime, pasuar nga NISMA dhe LS me rreth 260 mijë euro shpenzime secila, si dhe AKR me rreth 120 mijë euro shpenzime.


Në bazë të këtyre të dhënave, shihet se edhe gjatë këtij viti, subjektet politike kanë deklaruar bilanc negativ, me gjithsej gati 800 mijë euro më shumë shpenzime, sesa që kanë pasur në fakt të hyra, siç do të paraqitet në tabelën në vijim. Pothuajse të gjitha subjektet politike kishin raportuar për bilanc negativ financiar edhe gjatë vitit 2017, me gjithsej mbi 2,2 milion euro deficit.

Në bazë të këtyre të dhënave, shihet se edhe gjatë këtij viti, subjektet politike kanë deklaruar bilanc negativ, me gjithsej gati **800 mijë euro** më shumë shpenzime, sesa që kanë pasur në fakt të hyra, siç do të paraqitet në tabelën në vijim. Pothuajse të gjitha subjektet politike kishin raportuar për bilanc negativ financiar edhe gjatë vitit 2017, me gjithsej mbi **2,2 milion euro** deficit.



Grafikoni 1.

Bilanci i shpenzimeve dhe të hyrave të subjekteve politike për vitin 2019



SI I SHPENZUAN PARATË SUBJEKTET POLITIKE?


Duke qenë se subjektet politike kanë deklaruar se pjesën më të madhe të të hyrave e marrin nga buxheti i shtetit, përkatësisht paratë e taksapaguesve, është më se e rëndësishme të shihet edhe mënyra se si ato i kanë shpenzuar mjetet e tyre. Në bazë të formularëve të dorëzuar në KQZ, shpenzimet e subjekteve politike ndahen përgjithësisht në këto kategori dhe nënkategori:

- 1 Pagat dhe kompensimet – ku përfshihen edhe kontributet pensionale të punëmarrësit dhe punëdhënësit;
- 2 Shpenzimet e transportit – që përfshin automjetet e huazuara, karburantet, biletat e mjeteve të transportit, sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave, si dhe shpenzime tjera;
- 3 Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat – ku përfshihen lokalet dhe ushqimi për këto aktivitete, si dhe aktivitetet kulturore/rekreative, radio dhe sportet televizive, stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta, dhe shpenzimet tjera;
- 4 Shpenzimet e fushatës;
- 5 Blerja e mallrave – ku përfshihen furnizimet e zyrës dhe pajisjet tjera;
- 6 Shpenzimet e përgjithshme – ku përfshihen qiraja, telefoni, interneti, posta, rryma dhe shpenzimet komunale, si dhe shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë dhe ato lidhur me donacionet apo kontributet në natyrë (provizionet);
- 7 Shpenzimet e ndryshme – ku përfshihen mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave, si dhe shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër.

Bazuar në të dhënat e ofruara në raportet vjetore financiare të subjekteve politike, shihet se subjektet politike gjatë vitit 2019, pjesën më të madhe të shpenzimeve i kanë pasur për fushatë dhe për paga dhe kompensime.

Në kategorinë e shpenzimeve të fushatës, nga subjektet politike parlamentare janë shpenzuar mbi 2 milion e 150 mijë euro gjithsej, në kuadër të së cilave prin LDK me mbi 700 mijë euro. Në anën tjetër, në kategorinë e pagave dhe kompensimeve¹⁰ janë deklaruar shpenzime të përgjithshme në vlerë prej 1 milion e 322 mijë euro, ku prin PDK me rreth 420 mijë euro të shpenzuara. Shpenzimet e ndryshme (858,020 euro), shpenzimet e përgjithshme (561,333 euro), reklamat, reprezentacioni dhe konferencat (398,352 euro), shpenzimet e transportit (131,922 euro) dhe blerja e mallrave (66,017 euro), paraqesin kategoritë tjera të shpenzimeve të subjekteve politike.

Sa i përket shpenzimeve të fushatës, ndonëse është kategoria ku janë shpenzuar më së shumti mjete nga subjektet politike, ekzistojnë dallime mes deklarimeve të subjekteve politike mbi shpenzimet e përgjithshme të fushatës dhe raportit të DnV-së për vëzhgimin e zgjedhjeve. Sipas vlerësimit të DnV-së janë shpenzuar 3 milion e 636 mijë euro, apo rreth 1 milion e gjysmë euro më shumë sesa deklarimet e subjekteve politike.



**Bazuar në të dhënat e ofruara
në raportet vjetore financiare
të subjekteve politike, shihet se
subjektet politike gjatë vitit 2019,
pjesën më të madhe të shpenzimeve
i kanë pasur për fushatë dhe për
paga dhe kompensime.**

¹⁰ Në kuadër të kategorisë së pagave dhe kompensimeve, sipas raporteve, vetëm një subjekt politik (PAI) nuk ka paguar tatimet/kontributet e parapara me ligj. Ndërsa, dy subjekte tjera (NISMA dhe LS) kanë deklaruar të dhëna jo të plota dhe konkrete lidhur me kategorinë e kontributeve pensionale, meqenëse kjo kategori nuk përputhet me kategorinë e pagave – sipas përqindjes së paraparë ligjore.




Subjekti politik	Deklarimi i subjektit	DnV
LDK	735,541.87€	1,207,191€
PDK	316,966.37€	819,270€
AAK-PSD	462,041.20€	696,632€
LVV	431,039.63€	413,714€
NISMA-AKR-PD	115,863.80€	319,029€
LS	89,383.44€	112,433€

Tabela 1. Dallimet mes shpenzimeve të deklaruara nga subjektet dhe të dhënave të mbledhura nga DnV lidhur me fushatën zgjedhore të vitit 2019

Ndërsa, nëse kategorizimet e shpenzimeve shihen për secilën parti veç e veç, atëherë vërehet që subjektet politike kanë qasje të ndryshme lidhur me mënyrën e shpenzim-

it të parave të tyre. Në vijim janë të paraqitura grafikisht shpenzimet e subjekteve politike parlamentare, sipas kategorive të raportuara.



|||||

Subjekti politik	Paga dhe kompenzime		Shpenzime të transportit		Reklama, reprezentacion dhe konferenca	
	€	%	€	%	€	%
AAK	€ 50,840.23	8%	€ 491.64	0%	€ 25,528.37	4%
AKR	€ 16,795.61	14%	€ -	0%	€ -	0%
ALTERNATIVA	€ 1,461.72	6%	€ 66.00	0%	€ 5,190.00	20%
IRDK	€ -	0%	€ -	0%	€ -	0%
JGP	€ 4,629.55	23%	€ 5,712.30	28%	€ 6,099.70	30%
KDTP	€ 11,596.81	14%	€ 2,783.54	3%	€ 16,992.32	20%
LDK	€ 261,636.66	20%	€ 38,572.85	3%	€ 173,961.79	13%
LVV	€ 411,296.49	36%	€ 56,587.63	5%	€ 56,871.87	5%
NDS	€ 4,813.99	13%	€ 1,941.81	5%	€ 6,648.84	18%
NISMA	€ 57,732.78	22%	€ 1,902.77	1%	€ 22,860.00	9%
PAI	€ 17,000.00	52%	€ 4,000.00	12%	€ 3,500.00	11%
PDK	€ 419,104.61	31%	€ 2,488.91	0%	€ 43,423.93	3%
PLE	€ 12,890.60	37%	€ 4,965.65	14%	€ 8,211.67	24%
PRBK	€ 22,870.86	72%	€ 2,842.21	9%	€ 2,632.00	8%
SL	€ 16,993.75	7%	€ 7,217.49	3%	€ 17,299.50	7%
VAKAT	€ 12,801.62	20%	€ 2,350.00	4%	€ 9,132.30	14%

Grafikoni 2. Shpenzimet e subjekteve politike parlamentare sipas kategorive, mjeteve dhe përqindjes së tyre për vitin 2019

|||||

|||||

Shpenzimet e fushatës		Blerja e mallrave		Shpenzime të përgjithshme		Shpenzime të ndryshme	
€ 462,041.20	77%	€ 4,307.91	1%	€ 50,140.99	8%	€ 8,222.77	1%
€ 58,053.54	48%	€ 14.00	0%	€ 38,348.17	32%	€ 6,847.30	6%
€ -	0%	€ 399.00	2%	€ 17,154.52	65%	€ 1,989.00	8%
€ -	0%	€ -	0%	€ -	0%	€ -	0%
€ 1,905.00	9%	€ 419.00	2%	€ 1,372.68	7%	€ -	0%
€ 33,736.94	40%	€ -	0%	€ 19,138.98	22%	€ 816.46	1%
€ 735,541.87	55%	€ 5,710.32	0%	€ 76,775.27	6%	€ 47,399.40	4%
€ 431,039.63	37%	€ 16,561.62	1%	€ 174,778.67	15%	€ 11,084.11	1%
€ 13,901.30	37%	€ 4,888.74	13%	€ 4,552.59	12%	€ 1,198.01	3%
€ -	0%	€ 4,113.91	2%	€ 80,735.29	31%	€ 93,923.50	36%
€ 4,000.00	12%	€ 2,500.00	8%	€ 1,000.00	3%	€ 500.00	2%
€ 316,966.37	23%	€ 5,142.35	0%	€ 63,283.72	5%	€ 509,205.67	37%
€ 7,298.00	21%	€ 93.25	0%	€ 99.15	0%	€ 1,143.00	3%
€ 3,400.90	11%	€ -	0%	€ -	0%	€ -	0%
€ 89,383.44	34%	€ 4,495.00	2%	€ 30,000.00	12%	€ 95,406.50	37%
€ -	0%	€ 17,372.11	27%	€ 3,953.96	6%	€ 18,661.82	29%

|||||



DONACIONET E SUBJEKTEVE POLITIKE

Një prej burimeve të lejuara për financimin e subjekteve politike në Kosovë janë kontributet¹, përkatësisht donacionet që i jepen subjektit politik, kryesisht në para në gatshme, ndonëse nuk përjashtohen as të mirat tjera materiale. Në bazë të ligjit, subjektet politike janë të lejuara të marrin donacione nga personat fizikë dhe ata juridikë, nën kufizime të përcaktuara për shumën e përgjithshme që mund të pranohet brenda një viti kalendarik. Për personat fizikë, kufizimi është 2 mijë euro brenda një viti kalendarik, ndërsa për ata juridik 10 mijë euro brenda vitit kalendarik.

Në këtë drejtim, raporte të shumta vendore² dhe ndërkom-bëtare³ kanë ngritur shqetësim për tejkalimin e këtyre normave nga subjektet politike dhe moskontrollin financiar, përkatësisht ndëshkimeve, ndaj shkelësve të ligjit.

Përgjatë vitit 2019, sipas raporteve financiare të subjekteve politike parlamentare, ato kanë pranuar gjithsej 214,566 euro donacione, që paraqet vetëm 4.6% të të hyrave të përgjithshme që ata kanë pasur. Rreth 12 mijë euro tjera janë deklaruar si kontribute në natyrë që këto subjekte (LVV, NISMA dhe PDK) i kanë përfituar. Të gjitha subjektet politike parlamentare shqiptare kanë deklaruar se kanë pranuar donacione, ndonëse shumat e tyre variojnë nga 38 euro deri në 80 mijë euro. Ndërsa, vetëm PLE, si subjekt politik që përfaqëson komunitet jo-shumicë ka deklaruar donacione të pranuar. Në bazë të raporteve, vërehet se pjesa më e madhe e donacioneve që kanë pranuar subjektet politike kanë ardhur nga anëtarë të tyre, në vlera prej 10 deri në 1,000 euro.

Në një rast⁴, është vërejtur një tejkalim i kufirit të përcaktuar ligjor për donacionet. Subjektet politike, të cilat përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë në Kuvendin e Kosovës nuk kanë deklaruar asnjë donacion.

Përgjatë vitit 2019,
sipas raporteve financiare
të subjekteve politike
parlamentare,
ato kanë pranuar gjithsej

214,566
euro donacione,

që paraqet vetëm
4.6%
të të hyrave të përgjithshme
që ata kanë pasur

Subjektet politike që ka deklaruar më së shumti donacione është AKR, me gjithsej 80,413 euro, nga gjithsej 84 donacione përgjatë vitit 2019. Mbi 70 nga donacionet e pranuar nga ky subjekt politik janë në vlerë fikse 1000 euro, ndërsa tjerat në shuma më të vogla. Të gjitha donacionet janë të pranuar nga persona fizikë.

Pas AKR-së, renditet LVV me 49,885 euro të mbledhura, nga gjithsej 253 donacione. Shumica dërrmuese e tyre janë donacione në vlera të ulëta (5 deri në 50 euro). Vetëm 9 nga donacionet e pranuar nga ky subjekt janë dhënë nga persona juridikë. Pjesa tjetër janë nga persona fizikë, kryesisht anëtarë të këtij subjekti. LVV ka deklaruar kontribute në natyrë në vlerë të përgjithshme prej 11,304.51 euro.

1 Sipas definicionit ligjor, "Kontributet" paraqesin dhuratat (donacionet) ose ndihma e cילו lloj që nënkupton një akt të ndërgjegjshëm për t'i dhuruar të mira ekonomike apo të ngjashme për subjektin politik, goftë në para të gatshme, shërbime, shitja e gjësendeve nën çmimin e tregut, ofrimi i shërbimeve nën çmimin e tregut apo në të mira tjera material. Për më shumë, shih plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (2013), neni 2. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>

2 Për më shumë, shih Raportin e DnV-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të 6 tetorit 2019. I qasshëm në: http://demokracianeveprim.org/wp-content/uploads/2019/12/DnV_RAPORTI-I-V%C3%8BZHIGIMIT-T%C3%8B-ZGJEDHJEVE.pdf

3 Për më shumë, shih Raportin Përfundimtar të Misionit Vëzhgues të BE-së për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2019. I qasshëm në: https://eeas.europa.eu/election-observation-missions/eom-kosovo-2019/73409/european-union-election-observation-missions-kosovo-2019-early-legislative-elections-final_en

4 Sipas raportit vjetor financiar, kryetarja e subjektit politik Alternativa ka dhënë donacione në vlerë 2,100 euro për subjektin e saj politik, përkatësisht 100 euro më shumë se që është e lejuar. Këto donacione janë të dhëna në tri data të ndryshme.





Subjekti politik që ka deklaruar më së shumti donacione është

AKR

me gjithsej 80,413 euro

nga gjithsej 84 donacione përgjatë vitit 2019.

Alternativa, edhe pse me vetëm një mandat të fituar, edhe atë në kuadër të listës zgjedhore të LVV-së, është subjekti i tretë për nga donacionet e pranuar. Ky subjekt ka deklaruar 36,852 euro nga 56 donacione. Prej tyre, 16 janë nga persona juridikë, ndërsa pjesa tjetër nga persona fizikë.

PDK ka deklaruar 16 donacione, në vlerë të përgjithshme prej 35,897 euro. Të gjitha donacionet janë pranuar nga persona fizikë. Në kuadër të donacioneve të raportuara të këtij subjekti është përfshirë edhe një "specifikacion" në vlerë të përgjithshme prej 20,200 eurosh e cila në raport thuhet se ka të bëjë me gjobat e PZAP-it për deputetët. Nga këto mjete, 8,300 janë pranuar në bankë, ndërsa pjesa tjetër në arkë. PDK ka deklaruar gjithashtu donacione në formë të kontributeve në natyrë, në vlerë prej 520 euro.

NISMA ka deklaruar kontribute në vlerë prej 9,130 eurosh, të pranuar nga 84 donacione, të cilat janë ofruar nga persona fizikë – kryesisht anëtarë të këtij subjekti politik. Shumica e këtyre donacioneve janë në vlera të ulëta monetare. Ky subjekt politik ka deklaruar që ka pranuar kontribute në natyrë në vlerë prej 100 euro.

Shumica e këtyre donacioneve janë në vlera të ulëta monetare. Ky subjekt politik ka deklaruar që ka pranuar kontribute në natyrë në vlerë prej 100 euro.

AAK ka pranuar 1,850 euro kontribute, përmes 8 donacioneve, të cilat janë dhënë nga persona fizikë. Madje, pesë prej këtyre donacioneve janë ofruar nga i njëjti anëtar i këtij subjekti politik.

PLE ka deklaruar vetëm një donacion të pranuar nga jashtë vendit, nga Gjermania, prej një personi fizik.

LDK, ndonëse subjekti i dytë në zgjedhje, si dhe aktualisht udhëheqëse e koalicionit qeverisës, përgjatë tërë vitit 2019 ka deklaruar se ka pranuar vetëm një donacion. Ky donacion është dhënë nga një person fizik, dhe është deklaruar se është në vlerë prej vetëm 38.54 euro.


Në kuadër të subjekteve politike parlamentare, dhjetë prej tyre kanë faqe zyrtare elektronike të qasshme (LVV, LDK, AAK, NISMA, AKR, Alternativa⁵, LS⁶, IRDK, KDTP, PREBK). Ndër to, vetëm Lëvizja Vetëvendosje dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës⁷ e kanë të publikuar 'online' raportin vjetor financiar të paaudituar për vitin 2019.

5 Faqja zyrtare e subjektit politik Alternativa nuk është tërësisht funksionale.


6 Subjekti politik Lista Serbe e ka të publikuar vetëm raportin financiar të fushatës, por jo edhe atë vjetor.

7 Raporti vjetor financiar i publikuar nga AAK (2 faqe) përmban vetëm informacione të përgjithshme lidhur me pasuritë, ekuitetin dhe detyrimet, të hyrat dhe shpenzimet.

LDK, ndonëse subjekti i dytë në zgjedhje, si dhe aktualisht udhëheqëse e koalicionit qeverisës, përgjatë tërë vitit 2019 ka deklaruar se ka pranuar vetëm një donacion. Ky donacion është dhënë nga një person fizik, dhe është deklaruar se është në vlerë prej vetëm **38.54 euro**.



Grafikoni 3. Shuma e përgjithshme e donacioneve të pranura nga subjektet politike parlamentare



Grafikoni 4. Numri i donacioneve të pranura nga subjektet politike nga personat fizikë dhe ata juridikë




PASQYRAT BANKARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Ndonëse ligji parasheh që subjektet politike, gjatë përpilimit të raporteve vjetore financiare duhet të përfshijnë kopje të bilanceve bankare për llogarinë e subjektit politik, në kuadër të raporteve të publikuara, shihet se kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar tërësisht.

Gjithsej pesë subjekte politike nuk i kanë përfshirë pasqyrat e tyre bankare në raportet vjetore financiare. Madje, tri nga këto subjekte që nuk i kanë publikuar pasqyrat bankare, janë subjekte të cilat përbëjnë koalicionin aktual qeverisës.

Konkretisht, subjektet që nuk kanë përfshirë pasqyrën bankare në raportet vjetore financiare janë LVV, LDK, AAK, LS dhe PAI. Pjesa tjetër e subjekteve i kanë publikuar pasqyrat e detajuara bankare për vitin 2019.

Ndonëse ligji parasheh që subjektet politike, gjatë përpilimit të raporteve vjetore financiare duhet të përfshijnë kopje të bilanceve bankare për llogarinë e subjektit politik, në kuadër të raporteve të publikuara, shihet se kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar tërësisht.





REKOMANDIMET

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, Instituti Demokratik i Kosovës ofron rekomandimet e mëposhtme, të cilat janë në funksion të garantimit të një niveli më të lartë të transparencës financiare të subjekteve politike, sidomos lidhur me raportet vjetore financiare:

- 1** Kuvendi i Kosovës duhet që sa më shpejtë të përmbyllë procedurën e prokurimit lidhur me caktimin e auditorëve të jashtëm për kontrollin financiar të raporteve vjetore të subjekteve politike;
- 2** KQZ duhet të kërkojë nga subjektet politike raportim në kohë, sipas standardeve dhe kërkesave ligjore;
- 3** KQZ duhet të gjobisë subjektet politike në rast të mospërbushjes së kërkesave ligjore;
- 4** KQZ të vazhdojë me publikimin e të gjitha raporteve të audituara dhe të paaudituar, të secilit subjekt politik;
- 5** KQZ të kërkojë raporte edhe më të detajuara mbi shpenzimet financiare të subjekteve politike, përfshirë shpenzimet e parasë, donacionet në para, në mallra dhe tjera;
- 6** ZRPPC të kujdeset që subjekteve politike t'u ofrohen këshilla të sakta lidhur me mënyrën e raportimit financiar – si në kohë të zgjedhjeve ashtu edhe në vite tjera jo-zgjedhore;
- 7** Subjektet politike duhet që në raportet e tyre financiare të ofrojnë të dhëna të detajuara mbi shpenzimin e mjeteve jo vetëm në nivel qendror, por edhe në degët/qendrat e subjekteve politike në nivel lokal;
- 8** Subjektet politike duhet të paraqesin ndaras nga raporti listën e qarkullimit bankar dhe listën e kontributeve të tjera në natyrë, si dhe të dhënat e personave që kanë ofruar këto kontribute.



Me përkrahjen financiare të:

TRANSITION